



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.453/11 prot.

Datë 11.03.2026

V E N D I M

Nr. 381 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.289/2026, datë 20.02.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-75392-02-05-2026, me objekt “Blerje shtypshkrime & kancelari, letër printeri për vitin 2026”, me fond limit 3,899,982 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 17.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik Marketing & Distribution ShPK me Nipt. J72124001N dhe adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, Rruga Iliria, Nr. 53 Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë.
Adresa: Sheshi 4 Heronjtë, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me Vendim Nr. 289/2026, datë 20.02.2026 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-75392-02-05-2026, me objekt “Blerje shtypshkrime & kancelari, letër printeri për vitin 2026”, me fond limit 3,899,982 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 17.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit duke përpiluar shtojcën sipas vendimmarrjes së KSHA-së, dhe publikuar në SPE.

3. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 3130/1 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën nr. 453/7 prot., datë 05.03.2026, me objekt “Zbatim Vendimi”, autoriteti kontraktor informon se ka zbatuar vendimin Nr. 289/2026, datë 20.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

I.3. Me shkresën protokolluar me tonën me nr. 451/8, date 10.03.2026, nga operatori ekonomik ankimues, drejtuar AK-së dhe KPP-së, me objekt Kërkesë mbi zbatim Vendimi, ankimuesi kundërshton veprimet e AK-së dhe shtojcën e publikuar, mbi moszbatim të vendimit mbi modifikime të specifikimeve teknike, shprehura me ankesën e tij.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën ardhur me nr. 3130/1 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën nr. 453/7 prot., datë 05.03.2026, me objekt “Zbatim Vendimi”, autoriteti kontraktor informon se ka zbatuar vendimin Nr. 289/2026, datë 20.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor, Komisionit të Prokurimit Publik kreu verifikime në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi dhe konstatoi se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcë për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Referuar vendimit të KPP-së si edhe përmbajtjes së shtojcës së publikuar në SPE, Komisioni mori në shqyrtim dokumentet dhe konstatoi se, autoriteti kontraktor në shtojcën e publikuar nuk ka

pasqyruar të gjitha modifikimet në specifikimet teknike të ankimuara nga operatori ekonomik dhe të pranuar nga KSHA e konkretisht:

Nuk ka publikuar foto apo modele për të gjithë artikujt shtypshkrime objekt ankimi si dhe

Nuk ka përcaktuar nr. faqesh art 2,4,8,9,10,11,12,15,19,20,21,22,24,25,26,29,30.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë nuk ka zbatuar vendimin e KPP-së. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën me të gjitha ndryshimet e kërkuara nga ankimuesi dhe të pranuar nga KSHA, në zbatim të vendimit mbi pranimin e ankesës.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-75392-02-05-2026, me objekt “Blerje shtypshkrime & kancelari, letër printeri për vitin 2026”, me fond limit 3,899,982 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 17.02.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën në SPE me të gjitha modifikimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

